



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:079573

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511026

CN.nr.7/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështjen juridike jokontestimore të propozuesit B.Sh. nga Prizreni, me propozim për ruajtje të testamentit, me datën 27 mars 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Procedura në këtë çështje juridike jokontestimore **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së propozuesit B.Sh. ish nga Prizreni.
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e propozuesit e marrin përsipër vazhdimin e procedurës.

**A r s y e t i m**

Propozuesi B.Sh. ish nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur propozim për ruajtjen e testamentit me datë 05.01.2023.

Gjykata me qëllim të procedimit të çështjes ka caktuar seancë për datë 24.04.2024, ku është ftuar pala propozuese me ftesë të rregullt, mirëpo nga fletëdergesa për dorëzim personal e datës 19.03.2024, është kthyer konstatimi "se pala ka ndërru jetë me datë 03.10.2023".

Gjykata me qëllim të vërtetimit të këtij fakti, me datë 20 mars 2024, i'u është drejtuar me kërkesë Komunës së Prizrenit-Drejtorisë së Administratës, për njoftimin nëse këtu

pala propozuese B.Sh. ka ndërruar jetë. E njëjta me parashtrësën e datës 25.03.2024, ia ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes për propozuesin B.Sh.

Nga analizimi i certifikatës së vdekjes me nr.serik V10670364, numër të referencës 20/2023RV/20001/, me numër rendor 663, të datës 22.03.2024, gjykata vërtetoi faktin se B.Sh., i lindur me datë 15.10.1942 në fshatin Skorobishtë, Komuna e Prizrenit, me adresë të fundit të vendbanimit ..... në Prizren, e me numër personal .... ka ndërruar jetë me datë 03.10.2023, në Prizren.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 3 të LPJK-së, lidhur me nenin pika 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), si dhe nenin 18 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**CN.nr.7/23, me datë 27 mars 2024**

**Gjyqtari**  
**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.